

AKT – THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESITE KUFIZUAR

“ERA FASHION DESIGN” sh.p.k.

Sot ne daten **09.02.2021**, un ortaku themelues :

Z. Arben Ismalaj, shtetas shqiptar, i datelindjes **09.09.1967**, atesia **Murat**, lindur ne **Dragobi**, banuese ne **Durres Lagjja nr 17**, **Rruga Adem Jashari**, pallati **10 katesh**, i pajisur me id nr **G70909038J**, leshuar me date **02.06.2020**, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “**ERA FASHION DESIGN**” sh.p.k.

NENI 1 EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet “**ERA FASHION DESIGN**” sh.p.k. dhe eshte person juridik shqiptar.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901, date 14.04.2008, si edhe te ligjit per QKR-en.

NENI 2 SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne adresen : **Lagjja nr 17 Rruga Adem Jashari**, pallati **10 katesh**, zk **8513 nr pasurie 13/289-N4**, ish kenete.

Shoqeria mund te krijoje filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kryej aktivitet si me poshte :

Aktiviteti i regjimit te perpunimit aktiv (fason). Hapje linje rrobaqepesie, konfeksione me lende te para, material porositesi, lekure, inkelit, metrazhe, pelhure, per prodhim: peliceri, prodhim kepucesh, canta lekure, cdo produkt lekure, canta tesuti, rroba pune, veshje te ndryshme. Krijimin e markes. Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice, import dhe eksport, te artikujve industrial, i rrobave dhe konfeksioneve te shumellojshme, te stileve dhe modeleve klasike, sportive dhe te brendshme, trikotazheve, lekure, inkelit, parfume, kozmetike, si dhe me te gjitha llojet e metrazheve (stofra), produkte ushqimore, transportin e tyre brenda dhe jashte vendit. Shoqeria mund te veproje ne sektorin e pasurive te paluajshtme, akomodimin turistik, ushqimor, te lundrimit dhe te hotelerise. Shoqeria gjithashtu mund te zhvilloje cdo aktivitet tjeter te konsideruar te nevojshem ose te domosdoshem per permbushjen e objektit te shoqerise.

**NENI 4
KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali i shoqerise "ERA FASHION DESIGN" sh.p.k. eshte 100.000 (njqindmije) leke

Ky kapital perbchet nga 1- nje kuote dhe zoterohet nga :

Z. Arben Ismalaj qe zoteron 100 % te vleres te kapitalit te shoqerise te barabarta me vleren 100.000 leke .

**NENI 5
KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

**NENI 6
ORGANET E SHOQERISE**

-Asambleja e pergjithshme

-Administratoret

ASAMBLEJA E PERGJTHSHME

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

-Ndryshimin e Statutit.

-Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve

-Emerimin dhe shkarkimin e likujducsave dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.

-Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likujducsin dhe ekspertin kontabel.

-Mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga aministratoret, perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

-Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

-Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.

-Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

-Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

-Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti

ADMINISTRATORET

Administrator i shoqerise do te jete **Z. Arben Ismalaj**, shtetas shqiptar, i datelindjes **09.09.1967**, atesia **Murat**, lindur ne **Dragobi**, banuesc ne **Durres-Lagjja nr 17, Rruga Adem Jashari ,pallati 10 katesh**, i pajisur me id nr **G70909038J**, leshuar me date **02.06.2020**, i cili emerohet per nje periudhe **5-vjecare**, me te drejte ripertesitje.

Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment nga asambleja, me shumice te thjeshte te votave, me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se **51 %** te kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TE SHOQERISE

Pjesa e fitimit qe i takon seicilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakevc pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 8

PRISHJA E SHOQERISE

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset :

a) kur mbaron kohczgatja e parashikuar ne themelimin e saj.

b) me vendim te asamblese se pergjithshme

c) me hapjen e procedurave te falimentimit

c) ne se nuk ka kryer veprmtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprmtarise ne perpurhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 per " QKR "

d) me vendim te gjykates

dh) per arsye te tjera te parashikuara ne statut

NENI 9

LIKUJDIMI I SHOQERISE

Ne rast te likujdimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likujdator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likujdimit.

Me vendim e posacem te Asamblese se Pergjithshme,te marre me shumice te kualifikuar,pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likujdatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likujduesit duhet te ftojne kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj Shoqeria e publikon dy here kete njoftim,me nje interval prej 30 ditesh,ne faqen e saj te internetit,si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 10 PERFUNDIMI I LIKUJDIMIT

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura,likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likujdimit dhe kerkon crregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likujduesit nuk mund te kundershohet pas crregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

NENI 11 MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast te kundert, ortakët themelues do të drejtohen Gjykatës kompetente për zgjidhje.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“ ERA FASHION DESIGN ” sh.p.k.

Arben Ismalaj
